



Komisioni për Implementimin e Rindërtimit  
për lokacionet religjioze Ortodokse në Kosovë

## KOMUNIKATË PËR SHTYP 9 mars 2006

### FILLON FAZA E DYTË E RINDËRTIMIT TË LOKACIONEVE RELIGJIOZE

Pas pauzës së dimrit, Komisioni për Implementimin e Rindërtimit (KIR) ka filluar fazën e dytë të procesit të rindërtimit të lokacioneve religjioze të dëmtuara në mars 2004. Përderisa faza e parë e përfunduar në vitin 2005 ishte e suksesshme në mbrojtjen e 30 lokacioneve dhe parandalimin e dëmtimeve të mëtejshme, faza e dytë që do të kryhet në vitet 2006 dhe 2007 do të përbëhet nga rindërtimi i gjerë në lokacionet me prioritet.

Është arritur pajtimi për kushtet politike, institucionale dhe financiare dhe strategjitë në mes të partnerëve të ndryshëm: Këshillit të Evropës (KiE), Bashkimit Evropian (BE), Kishës Ortodokse Serbe (KOS), dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS) të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse (IPVQ). Si rezultat, Termet e rishikuara të Referencave janë duke u shpërndarë te të gjithë parterët e drejtpërdrejt për aprovim.

Në ndërkohë, KIR ka qenë i angazhuar në kompletimin e çështjeve të papërfunduara nga faza e parë, ndryshimin e kushteve të punës, planifikimin e intervenimeve të reja dhe sigurimin e fondeve dhe përkrahjes nga të gjithë partnerët. Fillimi i intervenimeve në vitin 2006 do të filloj menjëherë me kulmin e kishës së Virgjëreshës së Shenjtë Ljeviska në Prizren, siç është arritur pajtimi vitin e kaluar. Ky është prioritet i lartë pas vjedhjes së dy kulmeve më të ulëta nga të cilat është vjedhur plumbi. Parashihet që shumica e punëve të rindërtimit në vitin 2006 do të fokusohen në lokacionet në Prishtinë dhe Prizren.

KIR pritet të mbajë takimin e parë në prill 2006 ku pritet të shikohen intervenimet më të gjera dhe më komplekse në krahasim me vitin e kaluar si dhe një qasje më gjithëpërfshirëse për ruajtjen e trashëgimisë në Kosovë. Duke njohur nevojën për të sjellë nivelin e ekspertizës në këtë fushë në pajtim me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, KIR është zotuar të shfrytëzoj mundësinë e prezantuar përmes punës së vet në vitin 2006 për të ndërtuar kapacitete dhe të ofroj trajnime për ekspertët lokal, institucionet dhe të tjerë që janë përfshirë në fushën e ruajtjes së trashëgimisë kulturore. Si mjet tjetër i mbrojtjes afatgjate të lokacioneve, KIR gjithashtu do të kërkoj promovimin e vetëdijes publike, respektin dhe tolerancën në lidhje me trashëgiminë e vlefshme, kulturore dhe natyrore të Kosovës.

KIR është themeluar në qershor 2005 si rezultat i marrëveshjes në mes të KOS dhe IPVQ për të financuar intervenimet në Lokacionet Religjioze Ortodokse të dëmtuara në mars 2004. Kryesohet nga KiE dhe përfshin përfaqësues MKRS, KOS, dhe Institucioni për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës në Beograd.



Zyra e Sekretariatit të KiE në Kosovë, Ndërtesa UNHCR HQ, kati i 6, Kragujevci 8, 10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel : +381 (0) 38 243- 749 / 750 / 751 - Fax : +381 (0) 38 243 752

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Dhoma 132, Nëna Terezë Nr. 35, Prishtinë, 10000, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 20022- 054 / 059/ 073 - Fax: +381 (0)38 200 220 62